



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, nenit 19, par.1, pika b dhe të nenit 40, par.3, pika II të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.10.2005 merr

V E N D I M **PËR HARTIMIN E PLANIT PËR VENDOSJEN E QOSHQEVE NË** **QYTETIN E PRISHTINËS**

Neni 1

Miratohet Vendimi për hartimin e Planit për vendosjen e qoshqeve në qytetin e Prishtinës.

Neni 2

Plani për vendosjen e qoshqeve do të hartohet dhe do të realizohet në faza, varësisht nga zonat përkatëse të qytetit të Prishtinës.

Plani për vendosjen e qoshqeve do të përbëhet nga pjesa grafike, me të cilën përcaktohen lokacionet për vendosjen e kësaj kategorie të objekteve në hapësirat publike, në kuadër të zonave përkatëse të qytetit të Prishtinës.

Neni 3

Fazat e hartimit dhe të realizimit të planit, sipas këtij Vendimi, do të koordinohen me fazat e realizimit të planeve rregullative për lagjet përkatëse të qytetit të Prishtinës.

Secila fazë e hartimit të planit, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Zgjidhja arkitektonike e kësaj kategorie të objekteve të përkohshme është bërë sipas zgjedhjes së përcaktuar në bazë të konkursit të shpallur nga Komuna e Prishtinës. Vendosja e qoshqeve në lokacionet e përcaktuara me planet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës sipas fazave të hartimit të këtyre planeve, do të realizohet nga Komuna.

Mënyrat dhe procedurat e dhënies në shfrytëzim të qoshqeve të vendosura në lokacionet nga par.2 i këtij neni, do t'i rregullojë Komuna me akt të veçantë.

Neni 5

Hartimi i Planit, sipas këtij Vendimi, do të bëhet nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë I Komunës së Prishtinës.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.110-24896, më 28.10.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri